



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

VENDIM

Nr. 01, datë 09.12.2017


PËR
MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR SEKTORIAL NË FUSHËN E TURIZMIT NË
RAJONIN E ALPEVE SHQIPTARE

Në mbështetje të neneve 7, 10, 17 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të VKM Nr. 881, datë 14.12.2016 “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit”, të Vendimit Nr. 6, datë 29.12.2016 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e nismës për hartimin e Planit Kombëtar Sektorial, në fushën e Turizmit, në Rajonin e Alpeve Shqiptare” si dhe të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar Sektorial në fushën e Turizmit në Rajonin e Alpeve Shqiptare (PKST për Alpet Shqiptare), pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtëm:
 - a) Strategjia Sektoriale, shoqëruar me analizën sektoriale dhe territoriale, vizionin dhe objektivat strategjike të zhvillimit;
 - b) Plani i Zhvillimit të Sektorit, i cili përmban propozimet me përcaktime territoriale, planin e veprimeve dhe projektet e investimeve strategjike.
 - c) Rregullorja e Planit;
 - d) Vlerësimi Strategjik Mjedisor;
 - e) Materiali hartografik:
 - i. Harta e vizionit të zhvillimit të rajonit të Alpeve Shqiptare;
 - ii. Harta e destinacioneve turistike;
 - iii. Harta e transportit dhe lëvizjes;
 - iv. Harta e fazave kohore të projekteve.

2. Gjatë hartimit të planeve të tjera sektoriale kombëtare, planeve të detajuara për zona të rëndësishme kombëtare, planeve sektoriale në nivel qarku, planeve të përgjithshme vendore, projekteve strategjike dhe pilot të zhvillimit, si dhe të tjera të ngjashme me to, autoritetet përgjegjëse të planifikimit dhe zhvillimit të territorit në nivel qendror, qarku dhe atë vendor, duhet të bazohen në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga Plani Kombëtar Sektorial në fushën e Turizmit në Rajonin e Alpeve Shqiptare (PKST për Alpet Shqiptare).
3. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për kontrollin e përputhshmërisë së dokumenteve të planifikimit, që hartohen nga autoritetet përgjegjëse të planifikimit të territorit, me përcaktimet e Planit Kombëtar Sektorial në fushën e Turizmit në Rajonin e Alpeve Shqiptare (PKST për Alpet Shqiptare).
4. Ngarkohen Ministrinë dhe institucionet e varësisë përgjegjëse për turizmin, mjedisin, infrastrukturën, energjinë, kulturën dhe bujqësinë, agjencitë përgjegjëse për zbatimin e projekteve, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Agjencia për Zhvillimin Rajonal 1, Këshilli i Qarkut Kukës, Këshilli i Qarkut Shkodër, Bashkia Tropojë, Bashkia Malësi e Madhe, Bashkia Shkodër, Bashkia Pukë, Bashkia Vau i Dejës, Bashkia Fushë-Arrëz, si dhe çdo autoritet tjetër fusha e veprimtarisë së të cilit lidhet me territorin subjekt të këtij vendimi, për zbatimin e Planit Kombëtar Sektorial në fushën e Turizmit në Rajonin e Alpeve Shqiptare (PKST për Alpet Shqiptare), si dhe bashkërendimin e punës me AKPT-në dhe ndërmjet tyre.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

BLENDI KLOSI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

